

VENDIM
Nr. 851, datë 4.11.2020

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 546, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE SHITESAVE MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SHTETET E HUAJA, TË ATASHEVE USHTARAKË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PERSONELIT CIVIL TË MINISTRISË SË MBROJTJES QË SHËRBEJNË NË PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-s, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE, TË PUNONJËSVE SHQIPTARË PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI NËPUNËS NDËRLIDHËS PRANË QENDRËS SECI, TË PUNONJËSVE SHQIPTARË PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI OFICERË KONTAKTI, PRANË MINISTRIVE TË BRENDSHME HOMOLOGE TË SHTETEVE TË NDRYSHME TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE TË PUNONJËSVE TË SEKRETARIATIT TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI PËRFAQËSUES TË KËSAJ MINISTRIE PRANË MISSIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BRUKSEL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, të ligjit nr. 113/2018, "Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe *Eurojust*", dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 546, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

a) Në fund të titullit të vendimit shtohen fjalët "... dhe prokurori i sistemit të prokurorisë për kohën që shërben si prokuror ndërlidhës pranë *Eurojust*, në Hagë, Holandë ...".

b) Pas pikës 1/5 shtohet pika 1/6, me këtë përmbajtje:

"1/6. Prokurori i sistemit të prokurorisë për kohën që shërben si prokuror ndërlidhës pranë *Eurojust*, në Hagë, Holandë."

c) Pas pikës 6/1 shtohen pikat 6/2, 6/3 dhe 6/4, me këtë përmbajtje:

"6/2. Paga mujore e punonjësit të përcaktuar sipas pikës 1/6 të këtij vendimi, përbëhet nga elementet, si më poshtë vijon:

a) "Paga bazë mujore", e cila është paga mujore bruto e pozicionit që prokurori ka mbajtur në momentin e komandimit si prokuror ndërlidhës; dhe

b) "Shtesa e përfaqësimit" në masën 40%, që llogaritet mbi "pagën bazë mujore", të përcaktuar sipas shkronjës "a", të kësaj pike.

6/3. Përveç pagës mujore, të përcaktuar, sipas pikës 6/2 të këtij vendimi, ky punonjës përfiton edhe kompensimin për koston e jetesës, në masën 230 (dyqind e tridhjetë) euro.

6/4. Për punonjësin e përcaktuar, sipas pikës 1/6 të këtij vendimi, trajtimi me pagë dhe kompensimi për koston e jetesës, sipas këtij vendimi, fillon nga data e fillimit të detyrës së tij pranë *Eurojust*."

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të fillojnë nga data e fillimit të detyrës së prokurorit ndërlidhës pranë *Eurojust* dhe, për vitin 2020, të përballohen nga fondet e miratuara për sistemin e prokurorisë, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe